



Kingdom of the Netherlands

Ky projekt është i finansuar nga Bashkimi Evropian

ZBATO (JMË) REFORMËN TONË!

Western Balkan PAR Monitor

Pse është inicuar WeBER?

Për më shumë se 15 vite shtetet e Ballkanit Perëndimor (WB) kanë kaluar nëpër procesin e demokratizimit dhe tranzicionit, duke realizuar reforma të thella strukturore, ekonomike dhe sociale qëpërmirësimine kanë pasur për qëllim modernizimin e shoqërive dhetës së qytetarëve të tyre. Proceset reformuese kanë qenë të nxitura nga aspiratat e këtyre shteteve për tu bërë anëtare të Bashkimit Evropian, dhe në masë të madhe janë formësuar nga proceset e integrimit në BE. Qeverisja e mirë zë vend qendor në projektin e integrimit evropian, ndërkohë që një administratë publike që mbështetë qeverisjen e mirë duhet të jetë e besueshme, e parashikueshme, e hapur, transparente, efikase, efektive, dhe illogaridhëne (e përgjegjshme) në raport me qytetarët. Si rrjetohojë, reforma e administratës publike është vënë në pah si një nga fushat kryesore të cilat duhet të perqendrohen shtetet në rrugëtimin drejt anëtarësimit në BE. Shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë qenë duke realizuar reforma në administratën e publike tash e sa vite, por që nga viti 2014 BE ka përcaktuar një sërë parimesh që duhet ndjekur dhe respektuar nga këto shtete në mënyrë që të kenë sukses në realizimin e aspiratave për anëtarësim në BE. Këto "Parime të Administratës Publike" paraqesin një emëruesh të përbashkët për reformën e administratës publike në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor, duke përcaktuar kështu shtegun drejt anëtarësimit në BE.

Por kush do ta vlerësoj progresin e shteteve të Ballkanit Perëndimor në arritjen (përbushjen) e këtyre parimeve? Aktualisht, procesi i kushtëzimit nga BE, në baza të rregullta siguron monitorim dhe vlerësim të jashtëm të progresit në realizimin e reformave. Sidoqoftë, zgjerimet e mëparshme kanë treguar se pas anëtarësimit, kushtëzimi i BE-së zbutet, duke ndikuar kështu që shumë shtete të rrëshqasin pas në procesin e reformave, dhe të mbesin pas standardeve të qeverisjes së mirë. Në shumë shtete Qeveritë kanë ulur standardet e transparencës, kanë politizuar sërisht administratën, dhe kanë tkurrur përpjekjet në luftën kundër korruptionit.

WeBER është dizajnuar me idenë se vetëm përmes fuqizimit të akterëve vendor jo-qeveritar dhe forcimit të demokracisë pjesëmarrëse në nivel nacional dhe lokal, Qeveritë mund të mbahen nën presionin e njejtë që edhe pas pranimit në BE të vazhdojnë implementimin e reformave të administratës publike, e që shpesh janë të dhimbshme dhe jo të konvenueshme. Andaj, pjesëmarrja e shoqërisë civile dhe medias në realizimin e reformave duhet të forcohet, duke i edukuar dhe duke ju mundësuar që të monitorojnë progresin, të vlerësojnë cilësinë e të arriturave dhe të propozojnë zgjidhje të reja të bazuara në analiza dhe dëshmi. Në këtë mënyrë, reforma e administratës publike mund të mbështes krijimin dhe implementimin e politikave gjithpërfshirëse dhe transparente të cilat kanë parasysh nevojat e qytetarëve.

Broshura informuese për WeBER

Çka?

Projekti i Mundësimit i Ballkanit Perëndimor për Monitorimin e Reformës në Administratën Publike nga Shoqëria Civile – WeBER, është projekt trevjeçar i finansuar nga Bashkimi Evropian në bashkëfinancim me Mbretërinë e Holandës.

Kush?

WeBER implementohet nga Rrjeti Think for Europe (TEN) i përbërë nga institutet nga Ballkani Perëndimor me orientim në politikat e BE-së. Projekti koordinohet nga Qendra për Politika Evropiane (CEP) me seli në Beograd. Përmes partneritetit me Qendrën për Politika Evropiane (EPC) me seli në Bruksel, WeBER do të siguroj vizibilitet në nivel të BE-së.

Si?

Synimi kryesor i WeBER është të rrisë relevancën, pjesëmarrjen dhe kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile dhe medieve në Ballkanin Perëndimor për të avokuar dhe ndikuar në dizajnimin dhe implementimin e reformës së administratës publike.

Metodologjia e përdorur nga WeBER përbëhet nga një sërë aktivitetesh që kanë për qëllim përmirësimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile të Ballkanit Perëndimor për të marrë pjesë në reformën e administratës publike, duke krijuar hapësirë për dialog me Qeverinë për reformat (plataforma rajonale për reformën në administratën publike), si dhe krijimin e platformës për dialog përbajtësor- Monitori i Reformës së Administratës Publike. Njëkohësisht kjo qasje promovon presionin rajonal në mes të shteteve duke vlerësuar shkallën e zbatimit të reformave përmes Fletënotimit Rajonal për Reformën e Administratës Publike, bazuar në procesin e monitorimit në secilin vend.

Vlera e përgjithshme e projektit është 1,273.411 Euro. Projekti është hapur në Shkurt të vitit 2016.

Kush e implements WeBER?



Gjithë struktura e partneritetit WeBER paraqitet në fotografinë më poshtë

WeBER implementohet nga gjashtë institute (think tanks) nga shtetet e Ballkanit Perëndimor, në ombrellën e Rrjetit Think for Europe - TEN (ten.europeanpolicy.org).

Qendra për Politika Evropiane (CEP) me seli në Beograd shërben si Sekretariat i TEN dhe koordinatore e projektit WeBER.

EPC me seli në Bruksel është partneri në nivel të BE-së, dhe është përgjegjës për të mbëshetur zhvillimin e rrjetit të TEN dhe rritjen e vizibilitetit të projektit në nivel të BE-së. .



Me kë bashkëpunojmë ne?

WeBER ka vendosur bashkëpunim (në rolin e bashkëpunëtorit të projektit) me ministritë dhe zyrat përgjegjëse për reformën e administratës publike në secilin nga shtetet e Ballkanit Perëndimor. Në nivel rajonal, Projekti bashkëpunim me Shkollën Rajonale për Administratë Publike (ReSPA), ku do të vendoset platforma e organizatave të shoqërisë civile për Reformën në Administratën Publike, përmes së cilës WeBER do të zhvilloj dialogun rajonal për reformat. Projekti do të bashkëpunoj edhe me Këshillin Rajonal për Bashkëpunim (RCC), përfshirë përputhshmëri në qasjen e monitorimit nga shoqëria civile duke u fokusuar në strategjinë SEE2020. Projekti do të mbaj kontakte të afërta dhe do të konsultohet me programin SIGMA të OECD, i cili kryen vlerësimë të rregullta për progresin e shteteve të Ballkanit Perëndimor në implementimin e Parimeve të Administratës Publike gjatë periudhës sa zgjat procesi i anëtarësimit në BE. Gjithashtu, WeBER konsultohet edhe me DG NEAR (Drejtoria e Përgjithshme për Politikat e Fqinjësisë dhe Zgjerimit) të Komisionit Evropian, duke përfshirë Qendrën për Ekspertizë Tematike (COTE) për reformën në administratën publike.

Për më tepër, projekti do të vendos bashkëpunim të fortë dhe aleanca me organizatat e shoqërisë civile të interesuara apo që tashmë janë duke punuar në reformën e administratës publike në shtetet e Ballkanit Perëndimor. Duke zhvilluar strategji të komunikimit përfshirjen e shoqërisë civile në monitorimin e reformës në administratën publike, WeBER do të mundësoj një qasje më të koordinuar dhe komplementare për organizata të ndryshme të shoqërisë civile, në përpjekjet dhe projektet e tyre të fokusuara në reformën e administratës publike.